



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 4151 Prot.

Vau Dejes me 25/07/2025

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (dh) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët dhe grupet e interesit në Bashkinë Vau Dejës, të bëhen pjesë me mendimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.

(Paraqitur nga Kryetari Bashkisë).

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **21.08.2025** ora **10.00** ne sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrave Bushat.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimet e mësipërm deri me datë 21.08.2025 , nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al ,facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 11, datë 25.07.2025

“PËR

**NDRYSHIMIN E VKB NR 84 DATË 23.12.2024 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË
VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2025
– 2027, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____._____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjin 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025,VKB-ne nr 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës ”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës, Shkresë nr. 4120 Prot datë 24.07.2025 “Kërkesë për Rishikim Buxheti viti 2025, viti 2026.

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2025 - 2027, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë ndryshimin e fondeve buxhetore me kapitull 05 (të ardhura), të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2025-2027 , të ndara në korente dhe kapitale, sipas tabelës 1 dhe tabelës 2 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI

Me Vendim Delegimi

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Integritetit dhe Aseteve

Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 1: "Shtese Projekti dhe Rishpermdarje e buxhetit ndermjet programeve te Kap 05".

PAKËSOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2025	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	09120	2300000	3333	1570625	9,064,961.00	Sistemin dhe rrethim I fushes se sportit ne shkollen Narac+Mbikqyrje+Kolaudim
SHUMA TOTALE										9,064,961.00

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2025	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	09120	2310000	3333		9,064,961.00	Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat
SHUMA TOTALE										9,064,961.00

Nëpunësi Zbatues
Elsa Tanushi



Nëpunësi Autorizues

Aleksandra Gjoni



Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 1: "Shtese Projekti dhe Rishperndarje e buxhetit nderrmjet programeve te Kap 05".

PAKESOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04240	2310000	3333	1570557	1,200,000.00	Blerje Tuba Betoni
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	06260	2300000	3333	1570813	700,000.00	Blerje materiale elektrike per ndricim
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	06260	2310000	3333	1570835	2,000,000.00	Blerje materiale ndertimi
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	08130	2310000	3333	1570867	1,000,000.00	Ndertim ambjente Sportive Vau Dejes+Mbikqyrje+Kolaudim
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	08220	2310000	3333	1570868	1,000,000.00	Rikonstruksion qendra kulturore Laç+Mbikqyrje+Kolaudim
			Bashkia Vau-Dejes							Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të pa
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	10661	2310000	3333	1570372	1,000,000.00	favorizuara+Mbikqyrje+Kolaudim
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	10430	2310000	3333	1570870	900,000.00	Rikonstruksion i godines kopesht per femije Vau Dejes
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04520	2310000	3333	1570854	1,264,961.00	Sistemim asfaltim rruga Pistull-Hajmel+Mbikqyrje+Koludim
SHUMA TOTALE									9,064,961.00	

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	09120	2310000	3333		9,064,961.00	Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat
SHUMA TOTALE									9,064,961.00	

Nëpunësi Zbatues
Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues
Aleksandra Gjoni



RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

NDRYSHIMIN E VKB NR 84 DATË 23.12.2024 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2025 – 2027, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”.

QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, duke plotësuar nevojat e bashkise Vau Dejes.

Duke u nisur nga shkresa Nr. 4120 Prot datë 24.07.2025 e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit drejtuar Sektorit të Financës me lëndë “Kërkesë për Rishikim Buxheti viti 2025, viti 2026” jemi angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore. Po ashtu ne buxhetin e vitit 2025-2026 do të bëhet shtesë e zërit me emërtimin “Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat”

Kjo shkresë ka ardhur në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës dhe FSHS-së, ku FSHF-ja është e angazhuar të bashkëfinancoje 50% të vlerës së investimit total prej 36,259,842.14 ALL.

Rishpërndarja e buxhetit do të bëhet sipas tabelës nr 1 dhe tabelës nr 2 përkatësisht për vitin 2025 dhe 2026 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi, për të mundësuar bashkëfinancimin nga ana e Bashkisë në vlerën 18,129,921.07 ALL

Kemi prekur zëra buxheti të investimeve që nuk janë pjesë e projekteve prioritare për vitin 2025, gjithashtu është bërë shtesë projekti për zërin “Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat” në zbatim të nenit 100 Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njesise së veteqeverisjes vendore, ligji nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit 2025”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës” miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 860/1 prot datë 06.01.2025. Me këtë projekt vendim zërat që pakësohen janë zëra ku ka mjaftueshmeri fondesh.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me:

- Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
- Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore, i ndryshuar
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”

- Ligji 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"
- Udhezimit Plotesues nr 02 date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025"
- Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025

Konceptoi: Elsa Tanushi



KRYETAR
Kristian Shkreli

Me Vendim Delegimi
ZV/KRYETAR
Aleksandra Gjoni

